Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

#### 1.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi kryesor i projektit është përmirësimi i infrastrukturës dhe rritja e sigurisë sipas standardeve të njohura të sigurisë dhe praktikave më të mira në rrjetin e Matje-ve.

#### 1.2 Qëllimi

Duke vlerësuar me prioritet sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e sistemeve nga sulmet kibernetike, me qëllim minimizimin e rrezikut, OST sh.a. ka vendosur të veprojë dhe të realizojë një ristrukturim të infrastrukturës teknologjike të platformës së matjes së energjisë (Matjeve), SCADA/EMS, dhe sistemeve TI, etj.

Gjithashtu, duhet të identifikojmë kërkesat tona të ardhshme duke konsideruar stafin, proceset dhe fushat e teknologjisë. OST ka nevojë për zgjidhje eficiente, elastike dhe të sigurta, si dhe të jenë sa më praktike gjatë operimit të përditshëm dhe mirëmbajtjes.

Qëllimi i punës përfshin projektimin, ndërtimin, zhvillimin, vënien në punë, komisionimin dhe testimin e lidhjeve dhe komunikimit në çdo nyje të rrjetit të Matje-ve, për segregimin e domain-eve si entitete të ndara për komunikimin e kontrolluar sipas protokollove të mirëcaktuara, menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të komponentëve.

#### 1.3 Objektivat

Qëllimi përfundimtar i këtij angazhimi është të reagojë ndaj sofistikimit të sulmeve keqdashëse, si dhe t'i paraprijë ndryshimeve teknologjike për transformimin e vërtetë të prioriteteve dhe aktiviteteve OST. Gjithashtu, një nga objektivat kryesore të këtij angazhimi është vlerësimi, konceptimi dhe dizenjimi i një infrastrukture të segmentuar, por njëkohësisht efikase dhe elastike në përdorim, për të rritur performancën dhe sigurinë në përpunimin dhe transmetimin e informacioneve kritike.

Për të arritur këtë qëllim, ne i shohim objektivat e mëposhtëm si elementë të rëndësishëm për projektin tonë:

- 1) Përdorimi i një strukture me model zhvillimin e industrisë për të vlerësuar pikat e forta dhe dobësitë e gjendjes aktuale të infrastrukturës TI në të gjitha domainet dhe proceset e teknologjisë. Duhet të identifikojmë dhe vlerësojmë dobësitë kryesore, rreziqet dhe ekspozimin e mundshëm ndaj kërcënimeve kibernetike në infrastrukturën tonë;
- 2) Përcaktimi i një qëllimi të ardhshëm mbi sigurinë kibernetike, duke përfshirë identifikimin e çdo boshllëku midis gjendjes aktuale dhe asaj të ardhshme që duhet adresuar;

- 
- 3) Hartimi i një liste të rekomandimeve për përmirësimin e prioriteteve të përshtatshme dhe të zbatueshme, që përbëhet nga praktikat më të mira që adresojnë drejtpërdrejt mangësitë e identifikuar dhe ndihmon OST-në për të krijuar një plan për të arritur qëllimin tonë të ardhshëm.

Ofertuesi duhet të përgatisë një dokument të detajuar për masat që mund të merren për të zbuluar paraprakisht dhe për të parandaluar sulme kibernetike si:

Firewalls dhe/ose pajisje të tjera hardware për të parandaluar komunikime të panevojshme apo të përjashtuara nga rregullat e sigurisë, të segmentojë dhe monitorojë trafikun e rrjetit për të identifikuar akseset e paautorizuara.

Krijimi i një shtrese shtesë mbrojtje, duke vendosur elementë kontrollues dhe parandalues të aksesit.

#### **1.4 Rezultatet që Duhet të arrihen nga Kontraktori**

Kontraktori duhet të bëjë planin e detajuar, ta zbatojë dhe ta realizojë duke respektuar të gjitha standardet përkatëse të sistemeve, rrjeteve të komunikimit, praktikat dhe eksperiencat me të mira të sistemeve energjitike europiane.

Projekti duhet të konsiderohet “Turn Key”, pra me çelsa në dorë. Rezultatet që priten të arrihen nga kontraktori për këtë projekt janë:

- Rikonceptimi i rrjetit duke implementuar shtresën e re të mbrojtjes nga veprimtaritë keqdashëse nga jashtë. Ky rrjet do të lejojë shkëmbimin e të dhënave midis segmenteve të ndryshme vetëm nëpërmjet politikave të para-konfiguruar në Firewalls.

- 
- Përdorim i protokolleve të komunikimit standard dhe të besueshëm.
  - Menaxhim i centralizuar dhe automatizuar nëpërmjet një konsolle të vetme për firewall-et. Ky process mundëson administrim dhe vizibilitet të plotë të pajisjeve të rrjetit nëpërmjet mënyrave të thjeshta, të automatizuara dhe inovative.
  - Projektimi i rrjetit të komunikimit bazuar mbi infrastrukturën ekzistuese të sistemit të matjes online, SCADA/EMS, lidhjes me ENTSO-e, si dhe sistemeve të tjera të OST.
  - Përmirësim i infrastrukturës së Matjeve, jo vetëm nëpërmjet zëvendësimit të pajisjeve të vjetra, por edhe me dizajn modern sipas praktikave më të mira.
  - Projektimi i rrjetit duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
  - Përdorimi i pajisjeve të reja dhe ekzistuese të telekomunikacionit në nivel transporti.
  - Krijimi i rrjetit me arkitekturë që të garantojë redundancë të plotë të komunikimit.
  - Përdorimi i protokolleve të komunikimit standarde dhe të besueshme.
  - Rikonceptimi i nënrrjetave për të përfutur ndarjen e shërbimeve dhe lejimin e komunikimit të kontrolluar midis tyre.

## **2. SUPOZIMET DHE RISQET**

### **2.1. Supozimet e Projektit**

- Supozohet që kontraktori duhet të jetë i informuar për vendodhjen e sistemit ku do të kryhet implementimi i projektit si dhe të ketë parashikuar të gjitha shpenzimet operationale për të përmbushur procesin e lëvrimit pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor.
- Supozohet që kontraktori në zgjidhjen e vet teknike të konsiderojë çdo material dhe element pasiv apo aktiv si pjesë e impementimit të projektit.

### **2.2. Risqet**

Risku i procesit - është dështimi i proceseve ose sistemeve për shkak të konceptimit të gabuar të tyre, kompleksitetit ose mos-performimit të sistemit. Këtu mund të përmendim ndryshime domethënëse të situatës në funksionimin e rrjetit aktual, i cili mundet të çenohet gjatë procesit të ndërtimit të infrastrukturës së re IP.

Kjo kategori risqesh përfshin mangësitë teknike të personelit, skedulet jo korrekte të implementimit të programeve të ndryshme gjatë konfigurimit, respektimin e buxheteve të alokuara, zhvillimin e funksioneve të gabuara në program, ndërfaqen e gabuar nga përdoruesit etj. Këtu përfshihet dhe zëvendësimi i shpejtë i teknologjisë aktuale mund të sjellë kosto të lartë operationale gjatë impementimit të projektit.

## 3. QËLLIMI I PUNËS

### 3.1. Të Përgjithshme

#### 3.1.1. Përshkrimi i detyrës

Në realizimin e rrjetit të komunikimit, Kontraktuesi duhet të përdorë teknologjinë më të përparuar në dispozicion në aspektin e dizajnit dhe të projektimit dhe duhet të ofrojë fleksibilitet maksimal për të mundësuar në të ardhmen zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit në fjalë, duke pasur parasysh dinamikën dhe zhvillimin e parashikuar në vitet e ardhshme për sistemin energjetik në Shqipëri.

Pas vënies në punë të rrjetit të komunikimit me kusht, shtesat dhe përditësimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja operative duhet të bëhen të mundura përmes ndryshimeve të vogla apo me shtimin e moduleve lehtësisht të disponueshme në treg.


Projekti duhet të zhvillohet si një i tërë, pasi rrjeti do të segmentohet dhe komunikimi me jashtë do të ngrihet mbi pajisjet e reja firewall, duke u filtruar sipas politikave të OST. Nga këto pajisje trafiku do të drejtohet i përcaktuar te secili nga 'domainet' e OST. Nëpër pajisjet e reja 'routers' dhe 'firewalls' do të kalojë dhe filtrohet edhe trafiku i nënstacioneve që kalon nga rrjeta jashtë OST.

Sistemi i Komunikimit me pikat e matjes së energjisë realizohet nëpërmjet rrjetit GSM / GPRS të ofruara nga kompanitë celulare duke përdorur komunikimin IPsec VPN dhe TCP nëpërmjet OPGW të Rrjetit të Telekomunikacionit të OST sh.a.


Konfigurimi do të kryhet bazuar në protokolle të sigurtë, sipas praktikave më të fundit të rekomanduara nga prodhuesit.

Trafiku do të kalojë i centralizuar, për të shmangur përhapjen e anomalive në formë paralele, p.sh. nga një njësi në një tjetër.

Më poshtë janë paraqitjet skematike të rrjetit ekzistues dhe rrjetit të ri:



### *Paraqitja skematike e rrjetit ekzistues*



### *Paraqitja skematike e rrjetit të ri*

Përveç ndryshimeve të mësipërme, kontraktuesi duhet të rikonceptojë dhe dizajnojë rrjetin e brendshëm të domainit të Matjeve, duke zëvendësuar pajisjet ekzistuese, të cilat nuk ofrojnë performancën dhe sigurinë e nevojshme sipas kërkesave aktuale të nevojave të OST dhe ndryshimeve teknologjike e sulmeve kibernetike me të cilat po përballemi kohët e fundit.

Konfigurimi i pajisjeve do të jetë në çift (cluster) për të mos patur një pikë të shkëputjes së shërbimit (single point of failure) dhe në këtë mënyrë, për të mos ndërprerë shërbimet në rast të defektit të njërës nga pajisjet.

Firewall-et e nivelit të aplikimit do të sigurojnë dhe mbrojnë komunikimin në Internet nga ndërhyrjet e mundshme (viruset, malware, aplikime keqdashëse, etj.) dhe filtrojnë trafikun në të dy drejtimet.

Gjithashtu, në domainin e platformës së matjes së energjisë do të implementohet një zgjidhje e re për backup të makinave fizike dhe virtuale. Zgjidhja do të përmbajë software dhe backup në kasetë.

Kontraktuesi do të ketë detyrë të bëjë:

- Hartimin e një plani për ndërhyrjen në rrjetin ekzistues dhe në pajisjet aktive ekzistuese të OST, i cili do të paraqitet për aprovim nga OST. Kjo është e nevojshme për të shmangur çdo anomali dhe problem në funksionet ekzistuese nga ndërhyrja në rrjet.
- Planin e detajuar të konfigurimit të rrjetit.

- Ndarjen e shërbimeve dhe komunikimin me protokolle të mirëcaktuara midis domain-eve të ndryshme, duke përfshirë çdo lloj komunikimi të panevojshëm, me qëllim zvogëlimin e shtresës së sulmit.
- Planin e kryerjes së backup sipas standardit 3-2-1-1-0. Zgjidhja duhet të lejojë kryerjen e backup në kasete që do të ripërdoren si dhe kasete që lejojnë vetëm 1 shkrim dhe shumë lexime, për të mos lejuar modifikime.
- Implementimin e planit të miratuar nga personat e autorizuar në OST.

Kontraktori duhet të hartojë projektin teknik dhe çdo dokumentacion teknik dhe ta paraqesë në OST për miratim.

Gjithashtu, duhet të paraqitet për miratim në OST çdo pajisje që do të instalohet, ndryshime në konfigurimet ekzistuese apo punim që do të bëhet në kuader të projektit.

### 3.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Sistemi do të implementohet në ‘Datacenter’ qendror të OST.

### 3.1.3. Siguria e sistemit

Hyrja e fizike e kontraktorit në qendrat e të dhënave, sallat e të dhënave, dhe hapësira e dhomës së rrjetit do të jetë e kufizuar për ata me nevojë operacionale për të hyrë në ato hapësira dhe do kryhet e shoqëruar. Autorizimi u sigurohet personave që kanë nevojë për qasje në zonat e përcaktuara, bazuar në profilin e tyre të punës dhe që kanë marrë një kartë personale të hyrjes. Mjetet e aksesit fizik (p.sh. çelësat, kartat e hyrjes, kodet e hyrjes) do të shpërndahen në një mënyrë të kontrolluar në mënyrë që në çdo moment të kohës, të mund të merret një listë e plotë e individëve të emëruar që kanë qasje fizike. Aksesit në sistemet më kritike bazuar në vlerësimin e kritikitetit do të jepet përkohësisht vetëm nëse natyra e nevojës së biznesit për një person është gjithashtu e përkohshme (p.sh. për punën e lidhur me projektin). Proceset e punës për të përcaktuar natyrën e hyrjes së kërkuar do të vendosen në përputhje me të gjitha departamentet e përfshira.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

---

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmeria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Kjo procedurë i referohet pikes A 11 të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2013

### **3.2. Detyrat specifike**

Rrjeti i komunikimit duhet të sigurojë disponueshmërinë e kanaleve të nevojshme për transmetimin e të dhënave për të mbështetur aktivitetet dhe kontrollin, me një nivel të lartë të besueshmërisë. Kontraktori duhet të kryejë një vëzhgim në site “site survey”, në mënyrë që të njohë dhe të evidentojë pajisjet dhe mënyrën e ndërtimit të rrjetit.

Detyrat specifike të kontraktorit për realizimin e projektit të rrjetit të komunikimit duhet të fokusohen në realizimin e këtyre pikave:

- Konfigurimi dhe implementimi i pajisjeve të reja Firewalls, Routers, Switches dhe komponentëve të tjerë të nevojshëm për implementimin me sukses të projektit.
- Krijimi i një shtrese kontrolli dhe filtrimi shtesë për të gjithë komunikimet nga jashtë rrjetit OST, për të rritur sigurinë në komunikim dhe për të zvogëluar në maksimum sipërfaqen e rrezikut. Pajisjet firewall që do të përdoren për këtë shtresë do të jenë të ndryshme nga produktet aktuale, me qëllim që kontrolli të kryhet nga teknologji të ndryshme, për të shtresëzuar më tepër nivelet e mbrojtjes. Pajisjet firewall që disponon aktualisht OST janë produkte ‘Fortinet’ dhe ‘Barracuda’.
- Krijimi i VPN-ve dhe lidhjeve të tjera të komunikimit me sistemet e tjera të OST si dhe palët e treta. Kalimi i shërbimit në pajisjet e reja duhet të bëhet mundësisht pa ndërprerje të punës, ose në pamundësi të saj, me ndërprerje minimale, në oraret e dakortësuara me OST.
- Konfigurimi i pajisjeve të tjera të infrastrukturës për segregimin e rrjetit, sipas udhëzimeve të OST.
- Dështimi i një komponenti të vetëm ose mungesa e një lidhje nuk duhet të çënojë funksionimin e rrjetit në tërësi ose të asaj pjese të rrjetit. Rrjeti duhet të jetë redundant.
- Tranqet e ndryshme të rrjetit duhet të përbëjnë një rrjet elastik në të cilin të dhënat do të rrugëzohen automatikisht në prani të ndonjë bllokimi trafiku ose të ndonjë defekti.
- Projektimin e rrjetit duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Të përdoren protokolle komunikimi të përparuara dhe të sigurtë.



---

Rrjeti duhet të jetë transparent. Me qëllim që të sigurohet një komunikim dhe marrje e të dhënave në mënyrë të sigurt është i nevojshëm krijimi i sistemit bazuar në konfigurim redundat.

Pajisjet dhe modulet shtesë do të jenë në përputhje me karakteristikat e rrjetit dhe pajisjeve ku do të instalohen si dhe me funksionet e nevojshme për transmetimin e të dhënave.

Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe modulet shtesë për upgrade të telekomunikacionit të nevojshme për sistemin edhe pse nuk janë të përmendura në mënyrë specifike në dokumentacionin e projektit.

Informacion më i detajuar për konfigurimet aktuale të rrjetit do i jepet Kontraktorit në një moment tjetër, për të dizenuar topologjinë e zgjidhjes.

## **Testimi dhe dokumentacioni përfundimtar**

Në përfundim të projektit do të kryhet testim final i të gjithë sistemit. Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe aparatet testuese të nevojshme dhe të gjitha testimet do të jenë në ngarkim të tij. Kontraktori në përfundim të projektit duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin përfundimtar, në të cilin duhet të jenë:

- Projekti i zbatimit (përfundimtar)
- Specifikimet e produkteve
- Konfigurimet përfundimtare të pajisjeve
- Çertifikatat e pajisjeve
- Lista e pajisjeve dhe materialeve të furnizuara

## **4. LOGJISTIKA DHE KOHA**

### **4.1. Vendndodhja**

‘Datacenter’ qendror të OST.

### **4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 (tre) muaj nisur nga kjo datë dhe 1 (një) vit mirëmbajtje.

---

## 5. RAPORTIMI

### 5.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal dhe tre kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi tre faqesh duhet të prodhohet brenda një (1) jave, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresin në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të përbëhet prej maksimumi 10 faqesh. Ky raport duhet të dorëzohet 15 ditë para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me përfshirjen e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim të mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Informacion tjetër i rëndësishëm për raportet.

- 1- Raport instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit.
- 3- Inventari (HW, SW, etj).

### 5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar si ndjekës i kontratës. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

## 6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Diagramat dhe informacionet e nevojshme për komunikimin me sistemet e tjera do i vihen në dispozicion Kontraktorit në momentin e duhur.

## 7. GARANCIA

Periudha e garancisë së sistemit që do të implemetohet do të jetë 12 muaj.

## 8. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe

---

Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”.

### **Shërbimet e Mirëmbajtjes**

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në tre (3) muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/përfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktajnë ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë “Emergency On-Call Hours”. Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 60 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Zyrave Qendrore të Autoritetit Kontraktor/Përfituesit brenda intervalit kohor prej (4) katër orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një agjendë periodike kontrollesh (të cilat kur është e mundur mund të kryhen dhe nga distanca (remote)). Kontrollat janë si më poshtë:

### 3 (Tre) Mujore.

- e. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
- f. Kontroll i detajuar i log-eve hardware/software.
- g. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware/software.
- h. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

## 9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Sasia
1	Projekti teknik dhe Inxhinierik	1	Copë
2	Pajisje NG Firewall Model-1	2	Copë
3	Pajisje NG Firewall Model-2	2	Copë
4	Pajisje Router	2	Copë
5	Pajisje Switch	2	Copë
6	Sistemi i Backup	1	Copë
7	Instalimi, konfigurimi Asistenca Teknike	1	Copë
8	Asistence Teknike	1	Copë

## 10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Projekti duhet të marrë përsipër ndarjen në faza të implementimit si më poshtë:

**Faza e planifikimit dhe dizajnit (2 javë).** Gjatë kësaj periudhe, duhet të detajohet dhe përcaktohet me saktësi skema dhe arkitektura e zgjidhjes së propozuar, për të qenë sa më e përshtatur me nevojat aktuale, si dhe të shërbejë si hallka e parë drejt implementimit të produkteve dhe teknologjive të reja që do konsistojnë në rritjen dhe përmirësimin e sigurisë dhe performancës së rrjetit të OST. Kjo do të kryhet në bazë të një (ose më shumë) mbledhje (takim pune), dhe do të konkludojë me përpilimin e një skeme për krijimin e zgjidhjeve të rrjetit që do të implementohen. Duke u bazuar në këto raporte dhe arkitekturën e përmendur, duhet të hartohet një plan për shërbimet e implementimit. Plani duhet të hartohet konform gjithë standardeve industriale/teknike në këtë fushë të teknologjisë. Modeli i mësipërm do të

---

ndiqet në mënyrë që të arrihet një rezultat i kënaqshëm i implementimit të përmirësimit të infrastrukturës si nga ana e performancës ashtu edhe nga ana e sigurisë.

**Fazë implementimi (4 muaj).** Gjatë kësaj faze duhet të fillojë zbatimi i planit të implementimit që është detajuar në fazën e planifikimit. Në këtë projekt do të punohet duke implementuar sipas rradhës:

- **Lëvrimi i pajisjeve dhe instalimi fizik i tyre.**
- **Konfigurimi i pajisjeve Edge Routers.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në datacenter e OST qendër. Këto pajisje do të zëvendësojnë të gjitha funksionet ekzistuese që kryhen aktualisht nga router ekzistues (Cisco 2900) dhe gjithashtu, do të konfigurohen me protokollet, metodologjitë dhe politikat e sigurisë më të përshtatshme për të ofruar të gjithë funksionet, performancën dhe sigurinë shtesë që ka nevojë OST. Në këto pajisje do të kryhet konfigurimi për lidhjen e shërbimeve nga ISP-të si dhe trafiku i nënstacioneve të Matjeve që vjen nëpërmjet linjave GSM. Më pas trafiku do të lidhet me pajisjet firewall të konfiguruar në cluster (Active/Passive).  
Etiketimi i pajisjeve do të kryhet në bazë të etiketimit ekzistues, ose në rast të kundërt duhet të krijohet një mënyrë etiketimi që do ndihmojë administratorët në riparimet dhe shërbimet e nevojshme si dhe familjarizimin e tij me infrastrukturën e krijuar.
- **Konfigurimi i pajisjeve Edge NGFW dhe integrimi me infrastrukturën ekzistuese.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në godinën e Aparatit Qëndror në OST, përkatësisht në datacenter. NGFW e rinj do kryejnë funksionet e Edge Firewall. Ato do të konfigurohen për të ofruar të gjitha funksionet shtesë që kërkohen nga OST (si WebFilter, ATP, IPS, Application Visibility & Control, SSL VPN me web portal të sigurtë ... etj). Dy pajisjet NGFW do konfigurohen si një cluster Active/Standby redundant në zyrat qendrore. Duke qenë se rrjeti do të rikonceptohet dhe do të afektohen të gjitha domainet dhe komunikimet, duhet që dizajni të jetë konceptuar në mënyrë të saktë dhe të jetë testuar në ambient eksperimental. Ndërhyrjet për kalimin Live do të kryhen në periudha kohore që nuk afektojnë punën e sistemeve të OST, në bashkëpunim me IT dhe departamentet e tjerë.
- **Konfigurimi i pajisjeve NGFW – në platformën e matjes së energjisë dhe integrimi me infrastrukturën ekzistuese.** Pajisjet e reja duhet të instalohen në godinën e OST, përkatësisht në datacenter e Matjeve. NGFW e rinj do kryejnë funksionet e pajisjeve ekzistuese (Fortinet 100D). Ato do të konfigurohen për të ofruar të gjitha funksionet shtesë që kërkohen nga OST (si WebFilter, ATP, IPS, Application Visibility & Control,... etj). Dy pajisjet NGFW do konfigurohen si një cluster Active/Standby redundant në zyrat qendrore.
- **Konfigurimi i sistemit backup.** Pajisjet do të instalohen në godinën e OST, përkatësisht në datacenter e platformës së matjeve. Sistemi do të konfigurohet për të kryer backup të sistemeve në kasete, sipas përcaktimit nga stafi IT i OST. Backup do

të kryhet në kasete të rishkruajtshme dhe/ose në kasete që lejojnë vetëm 1 (një) shkrim dhe shumë lexime, në varësi të procesit dhe funksionit. Periodiciteti dhe lloji i backup, si dhe mënyra e rotacionit të kasetave do të vendoset së bashku me grupin e punës. Serveri që do të dedikohet për sistemin e backup do të ketë rolin e ‘backup gateway’.

Grafiku i lëvrimit të shërbimit mbas lidhjes së kontratës me Autoritetin kontraktor.

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4 – M15
1	Projekti teknik dhe Inxhinierik	X			
2	Pajisje dhe licenca	X	X	X	
3	Instalimi dhe konfigurimi		X	X	
4	Komisionimi dhe testimi			X	
5	Garancia	X	X	X	X

## 11. KËRKESAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE

### Funksionalitete

Arkitektura e re që do të propozohet duhet të sigurojë një strukturë të aftë për të ofruar shërbimin me cilësi të lartë në një kontekst të besueshëm, ku dështimi apo mungesa e një elementi të vetëm nuk do të shkaktojë ndonjë ndërprerje të komunikimit. Kontraktori ka përgjegjësinë e plotë për planifikimin e procesit të handover të shërbimit, nga infrastruktura ekzistuese në atë të re, duke garantuar mbajtjen e komunikimit të të dhënave në punë.

### Topologjia e kërkuar

Topologjia e re duhet të përfshijë pajisjet Routers dhe NGFW në konfigurimin ‘active/standby’ dhe switches në ‘stack’ sipas kërkesave të OST. Konfigurimet duhet të jenë fleksibël për t’u modifikuar dhe zgjeruar në të ardhmen në varësi të nevojave. Konfigurimet duhet të jenë të tilla që të eliminojnë loop-at.

Kalimi i shërbimit nga pajisjet firewall ‘active’ në atë ‘standby’ duhet të kryhet automatikisht dhe pa ndërprerje të shërbimit.

## 12. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PAJISJEVE TË KËRKUARA

Specifikimet teknike të hollësishme të rrjetit dhe sistemeve ekzistues do t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik fitues që do të implementojë përmirësimet e infrastrukturës së rrjetit ekzistues.

### Firewall NG IPS – Platforma e Matjes Sasia: 2 (dy) copë

NGFW	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, aksesorët e përfshirë;
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 12 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• Minimumi 4 porta/slote SFP (100/1000BASE-X);</li> <li>• 2 porta 10Gb që suportojnë transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë Console;</li> <li>• 1 portë USB</li> </ul>
<b>Throughput Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Firewall throughput të jetë min. 20Gbps;</li> <li>• IPS throughput të jetë min. 2.5Gbps;</li> <li>• NGFW throughput për shërbimet Firewall, IPS dhe Application Control të jetë min. 1.5Gbps;</li> <li>• Threat Protection Throughput për shërbimet Firewall, IPS, Application Control, URL filtering, and Malware Protection me sandboxing të aktivizuar të jetë min. 1Gbps;</li> <li>• Vonesa (latency) e Firewall të jetë jo më shumë se 5 µs;</li> <li>• Sesione konkurente (TCP) jo më pak se 1,500,000;</li> <li>• Sesione të reja (TCP) jo më pak se 55,000 në sekondë;</li> <li>• Politika firewall-i jo më pak se 10,000;</li> <li>• Ipv6 VPN throughput të jetë min. 11Gbps;</li> <li>• Tunelet IPsec VPN GW-to-GW të jenë min. 1500;</li> <li>• Përdorues konkurentë SSL-VPN të jenë jo më pak se 500;</li> <li>• Konfigurimet për HA (high availability) të jenë Active-Active dhe Active-Passive;</li> </ul>
<b>Karakteristikat</b>	Pajisja firewall duhet të suportojë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• IPS;</li> <li>• Filtrim të URL;</li> <li>• Filtrim të formatit video;</li> <li>• Analizim për programe/skedarë keqbërës (malware);</li> <li>• Karakteristika firewall për:               <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Të mundësuar njoftime, log-e, etj.;</li> <li>○ Fail 'Closed' State (bllokimi i gjithë trafikut 'Deny All Traffic');</li> <li>○ Mjete/aftësi për zgjidhjen e problemeve</li> </ul> </li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikim të aplikimeve;</li> <li>• Dekriptim të SSL;</li> <li>• Politika për shtresat 3 dhe 4;</li> <li>• Filtrim të DNS;</li> <li>• Autentikim nga distanca;</li> <li>• Autentikim me shumë faktorë;</li> <li>• Administrim i bazuar në role;</li> <li>• Raportime në sisteme SIEM;</li> <li>• Monitorim SNMP;</li> <li>• Mesazhe Syslog;</li> <li>• Rutime statike;</li> <li>• Tagim 802.1q të VLAN;</li> <li>• Mundësi të vendosjes manuale/statike të ARP;</li> <li>• Stateless Filtering të shtresës 3;</li> <li>• Funksionet e objekteve të filtrimit të gjendjes të shtresës 3;</li> <li>• Të suportoje 'Jumbo Frame';</li> <li>• Të suportoje LLDP;</li> <li>• FHRP/VRRP;</li> <li>• Të suportoje rutime: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ asimetrike,</li> <li>○ BGP,</li> <li>○ OSPF,</li> <li>○ RIP/RIPv2;</li> <li>○ Të bazuara në politika;</li> </ul> </li> <li>• Të suportoje QoS, QsS;</li> <li>• Të suportoje Multicast: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ IGMP Snooping;</li> <li>○ Suport të përgjithshëm;</li> <li>○ PIM Snooping;</li> <li>○ IGMP Leave/Fast-Leave;</li> </ul> </li> </ul>
<b>Power</b>	Të jetë i pajisur me dy blloqe ushqimi AC (redundant);
<b>Certifikimi</b>	ICSA Labs: Firewall, IPsec, IPS, Antivirus, SSL-VPN, IPv6
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 40 gradë Celsius
<b>Licensimi</b>	<p>Licensimi i pajisjes duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Veçoritë bazike të firewall. Të ketë mundësi për upgrade në full NGFW pa ndërprerje të shërbimit;</li> <li>• Veçoritë e rrjetit për shtresat L2/L3;</li> <li>• Suport VPN për IPSEC dhe SSL;</li> <li>• Licensë për SD WAN;</li> </ul>
<b>Garancia dhe suporti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) vit suport nga prodhuesi në nivelin 24 orë / 7 ditë;</li> <li>• Suport nëpërmjet WEB;</li> <li>• Suport nëpërmjet telefonit nga prodhuesi;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Suport i diferencuar në varësi të kriticitetit të problemit;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë përditësime e software të sistemit, përditësime të IPS dhe signaturave AVC, përditësime të Anti Malware Protection dhe Application Control për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> </ul>
--	---

**Firewall NG IPS - Edge      Sasia: 2 (dy) copë**

<b>Sistemi NG Firewall dhe IPS - Sasia 2 copë</b>	
<b>Lloji i pajisjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisje modulare 1RU (njësi rack);</li> <li>• Të përfshijë të paktën 8 porta 10/100/1000 Mbps R-J45 Base-T;</li> <li>• Të përfshijë të paktën 4 porta 1 Gbps SFP;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë 1 portë 1 Gbps (10/100/1000 Mbps BASE-T) RJ-45 të dedikuar për menaxhim;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë 1 portë console RJ-45;</li> <li>• 2 transmetues SFP dhe kabllat të përfshirë;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë 1 portë USB 3.0;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë të përfshirë të paktën një SSD me performancë të lartë me kapacitet minimum 200GB;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë një memorie prej të paktën 16GB;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë bllok ushqimi AC;</li> </ul>
<b>Kapaciteti dhe Licencimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi duhet të ketë Firewall throughput (sasia e informacionit që kalon në pajisje për inspektim) me kontroll të aplikacioneve (AVC) minimumi 3.2 Gbps;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë Firewall throughput (sasia e informacionit që kalon në pajisje për inspektim) me funksionet e NGIPS dhe kontroll të aplikacioneve (AVC) së bashku minimumi 3.2 Gbps;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë throughput NGIPS (detekton në mënyrë pasive pajisjet fundore dhe ato të infrastrukturës për korelim të kërcënimeve) minimumi 3.5 Gbps;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë inspektim TLS për të paktën 1.2Gbps Mbps;</li> <li>• Sistemi duhet të suportoje minimalisht 200.000 sesione me kontroll të aplikacioneve (AVC) në njësinë e kohës;</li> <li>• Sistemi duhet të suportoje minimalisht 20.000 sesione të reja në sekondë me kontroll të aplikacioneve (AVC);</li> <li>• Sistemi duhet të suportoje minimalisht 1.4Gbps IPSec VPN throughput me fast-path;</li> <li>• Sistemi duhet të suportoje minimalisht 400 VPN Peers;</li> <li>• Zgjidhja të përfshijë minimalisht 25 licenca për client-to-site VPN me software të gatshëm për konfigurimet e pajisjeve fundore dhe me suport për sistemet e operimit më të përdoshëm;</li> <li>• Zgjidhja të përfshijë minimalisht 20 kredite trainimi të prodhuesit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja duhet të përfshijë të gjitha licencat e nevojshme për shërbimet IPS Threat Protection, Anti Malware Protection dhe URL Filter për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e platformës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhja duhet të jetë e aftë të zbulojë, gjurmojë, kontrollojë, bllokojë dhe analizojë malware përgjatë kohës së incidentit dhe pas përfundimit të tij;</li> <li>• Zgjidhja duhet të ofrojë mbrojtje nga kërcënimet duke analizuar trafikun në rrjet për të zbuluar dhe ndaluar ndërhyrje të ndryshme;</li> <li>• Zgjidhja duhet të ofrojë kontroll të fileve, dhe filtrime në bazë të politikave të sigurisë.</li> <li>• Zgjidhja duhet të jetë e aftë të ndërtojë trajektoren e malware në rrjet;</li> <li>• Zgjidhja duhet të jetë e aftë të detektojë dhe kontrollojë aplikacione të modifikuara në gjuhën open source;</li> <li>• Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të ofrojë shikueshmëri dhe kontroll të përshtatshëm të aplikacionit për të paktën 4,000 aplikacione;</li> <li>• Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të marrë të dhëna të inteligjencës së kërcënimit IP, URL dhe DNS;</li> <li>• Zgjidhja duhet të jetë në gjendje të ofrojë filtrim URL për të paktën 80 kategori dhe 280 milionë URL;</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportojë integrimin e produkteve të palëve të treta përmes Open API;</li> </ul>
<b>Disponueshmëria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi duhet të suportojë disponueshmëri të lartë (HA) duke aplikuar standardin Active-Standby;</li> <li>• Të suportojë Static routes dhe protokollet standarde të routimit BGP, RIPv2 dhe OSPF;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë të paktën 512 nën-ndërfaqe (subinterface) VLAN, ndërfaqe pasive;</li> </ul>
<b>Veçoritë e menaxhimit dhe raportimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përfshijë ndërfaqe për konfigurim të pajisjes lokalisht ose remote me WEB duke përdorur HTTPS dhe CLI duke përdorur SSH;</li> <li>• Të jetë i pajisur me një ndërfaqe përdoruesi që të paraqesë përmbledhje mbi trendet dhe mundësi për detaje dhe analiza të thella.</li> <li>• Dashboard dhe raporte për pajisjet në rrjet, serviset që përdoren, kërcënimet dhe indikacione mbi rreziqet.</li> <li>• Të ketë mundësi të menaxhohet dhe monitorohet nga një platformë e vetme tërësisht e integruar, e cila ofron veçoritë e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Mbledhja pasive e informacionit për hostet e rrjetit dhe aktivitetet e tyre, si: sistemet operative, shërbimet, portat e hapura, aplikacionet e klientëve, dobësitë, korrelacioni i të dhënave të ndërhyrjes, eliminimi i rezultateve false;</li> <li>– Dukshmëri e plotë e rrjetit, duke përfshirë hostet fizikë dhe virtualë, pajisjet mobile, sistemet operative, pajisjet generike (si printerët, telefonat IP), aplikacionet, përdoruesit, përmbajtjen dhe dobësitë e mundshme të hostit dhe malware;</li> <li>– Një ose më shumë politika të përfshira IPS/IDS për instalim fillestar më të lehtë, me mundësi për rregullim dinamik të politikës IPS/IDS (p.sh. përzgjedhja e rregullave, konfigurimi i politikave, përditësimi i politikave etj.) me ndërhyrje minimale njerëzore;</li> <li>– Përditësimet automatike të rregullave IPS/IDS të publikuara nga prodhuesi dhe shpërndarja automatike e rregullave në firewall dhe/ose sistemet IPS/IDS;</li> <li>– Sinjalizim automatik për ngjarjet më kritike;</li> </ul> </li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Indikacione vepruese për të korreluar informacionin nga ngjarjet e rrjetit;</li> <li>- Nën sistem për planifikimin për të automatizuar detyrat e rrugëzimit, të tilla si: rezervimi, përmirësimet dhe zbatimi i politikave;</li> <li>• Regjistrimi i të gjitha aktiviteteve të administratorit, si në nivel lokal ashtu edhe në një server remote;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e mjedisit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temperaturat e lejuara: 0 – 40 gradë Celsius</li> <li>• Nivelet e lagështirës të lejuara: 10% deri në 85%, pa kondensim</li> </ul>
<b>Suporti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja duhet të përfshijë suport 24 orë në ditë, 365 ditë në vit nga qendra e asistencës teknike të prodhuesit nëpërmjet: email, telefon dhe faqes web për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë minimumi 1 (një) vit suport nga prodhuesi për hardware failures në ditën pasardhëse të punës (next business day) dhe disponueshmëri 5 ditë pune në javë;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë përditësime të software të sistemit, përditësime të IPS dhe signaturave AVC, përditësime të Anti Malware Protection dhe filtrime URL për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> </ul>

## Routers - Edge

**Sasia: 2 (dy) copë**

<b>Pajisje Router - Sasia 2 copë</b>	
<b>Lloji i pajisjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisje modulare 1RU (njësi rack);</li> <li>• Të përfshijë të paktën 6 porta WAN, 4 prej të cilave 10/100/1000 Mbps R-J45 Base-T dhe 2 porta SFP;</li> <li>• Të përfshijë të paktën 8 porta të shtresës (Layer) 2/3 100/1000 Mbps R-J45 Base-T ‘Switch Network Interface’;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë të paktën 1 portë console RJ-45;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë të paktën 1 portë USB 3.0;</li> <li>• 2 transmetues SFP dhe kabllat të përfshirë;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë storage të brendshëm 16GB me mundësi për upgrade në 1TB (M.2 NVMe);</li> <li>• Sistemi duhet të ketë një memorie prej të paktën 8GB, me mundësi për upgrade deri në 32GB;</li> <li>• Sistemi duhet të ketë 2 blloqe ushqimi AC redundante;</li> </ul>
<b>Kapaciteti dhe Licencimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 2Gb Isec throughput SD-WAN në njësinë e kohës;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 1.8Gb Isec throughput në njësinë e kohës;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 5.000 tunele SD-WAN (overlay);</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 19.5Gb throughput IPV4 forward në njësinë e kohës;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 4.000 tunele statike virtuale IPsec;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 4.000 lista të kontrollit të aksesit (ACL);</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 70.000 hyrje të aksesit të kontrollit (ACE) IPv4;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 1,5 milion rutime IPv4;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 1,2 milion sesione natimi (NAT);</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 512.000 sesione firewall;</li> <li>• Sistemi duhet të suportojë minimalisht 4.000 instanca të VRF;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë licence on-premise për trafik deri në 1Gb (i agreguar deri në 2Gb);</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë të gjitha licencat e nevojshme për shërbimet për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e platformës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhja duhet të rutojë në mënyrë dinamike trafikun nëpër linkun më të mirë, bazuar në kushtet aktuale të aplikacionit dhe rrjetit;</li> <li>• Zgjidhja duhet të optimizojë performancën e aplikacionit nëpërmjet veçorive si optimizimi i TCP, korrektimi i gabimit (FEC) dhe dyfishimi i paketave;</li> <li>• Zgjidhja duhet të ofrojë siguri me shumë shtresa;</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportoje teknologjitë VPN të tipit FlexVPN, DMVPN, GetVPN, etj.;</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportojë enkapsulime të tipit GRE, 802.1q VLAN, PPP, MLPPP, MLFR, HDLC, etj.;</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportojë komunikim të unifikuar për CAC, CUBE, ISDN, Radius, SIP, RSVP, VoIP, SRST, SRTP, etj.;</li> <li>• Zgjidhja duhet të mundësojë protokollat e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>- rutime statike IPv4 dhe IPv6,</li> <li>- RIP dhe RIPv2,</li> <li>- OSPF,</li> <li>- EIGRP</li> <li>- BGP,</li> <li>- IGMPv3,</li> <li>- RSVP,</li> <li>- VRRP,</li> <li>- PIM SM &amp; SSM,</li> <li>- IKE,</li> <li>- DHCP,</li> <li>- Frame Relay,</li> <li>- DNS,</li> <li>- SNMP,</li> <li>- OSPFv3</li> <li>- HSRP,</li> <li>- Radius,</li> <li>- AVC,</li> <li>- AAR,</li> <li>- DVMRP,</li> <li>- MPLS,</li> <li>- NAT,</li> </ul> </li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Netconf over SSH,</li> <li>- VPN të shtresës 2 dhe 3,</li> <li>- IEEE 802.1ag, dhe IEEE 802.3ah</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportojë menaxhim të trafikut të tipit QoS, PBR, PFR, NBAR, WRED;</li> <li>• Zgjidhja duhet të suportojë ‘Zero Touch Provisioning’;</li> <li>• Zgjidhja duhet të mundësojë algoritme kriptografie të tipit DES, 3DES, AES (128 &amp; 256), RSA, CBC, ECDSA, MD5, SHA-1, SHA-2, IKE, etj.;</li> <li>• Menaxhimi i pajisjes të mundësohet nëpërmjet CLI, SNMP, WebUI, Netconf, Restconf, etj.;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e mjedisit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temperaturat e lejuara: 0 – 40 gradë Celsius</li> <li>• Nivelet e lagështirës të lejuara: 10% deri në 85%, pa kondensim</li> </ul>
<b>Suporti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisja duhet të përfshijë suport 24 orë në ditë, 365 ditë në vit nga qendra e asistencës teknike të prodhuesit nëpërmjet: email, telefon dhe faqes web për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë minimumi 1 (një) vit suport nga prodhuesi për hardware failures në ditën pasardhëse të punës (next business day) dhe disponueshmëri 5 ditë pune në javë;</li> <li>• Pajisja duhet të përfshijë përditësime e software të sistemit dhe licencat e nevojshme, për një periudhë minimalisht 1 (një) vjeçare;</li> </ul>

## Switches      Sasia: 2 (dy) copë

<b>Switch Multi layer</b>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo më shumë se 40 cm aksesorët e përfshirë.
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb që suportojnë transeivera SFP+;</li> <li>• 1 modul për ‘stack’, kablli 50cm i përfshirë;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 4GB flash;</li> <li>• 2GB DRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 6 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/ Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mundësojë të paktën 1 rrjet virtual;</li> <li>• Të mundësojë numër të adresave MAC prej 16.000;</li> <li>• Të mundësojë një numër total të rutimeve direkte IPv4, jo më pak se 10,000;</li> <li>• Tabela e rutimit: 3.000 (IPv4), 1.500 (IPv6);</li> <li>• Të mundësojë minimalisht 1.000 rutime ‘multicast’;</li> <li>• Të mundësojë minimalisht 1.500 rregjistrime ACL;</li> <li>• Të mundësojë minimalisht 4000 VLAN ID;</li> <li>• Të mundësojë minimalisht 12.000 porta virtuale STP;</li> <li>• Të mundësojë paketa ‘jumbo frames’ prej jo më pak se 9.100 bytes;</li> <li>• Kapacitet për Switchim 128Gbps, me stack 208Gbps;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapacitet për forward të trafikut minimalisht 95 Mpps dhe 155 Mpps në stack;</li> <li>• Stakim dhe virtualizimi i teknologjisë duke bashkuar pajisjet në një grup duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson konfigurimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• Përmirësim dhe azhornim i sistemit gjatë punës;</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të jetë i pajisur me një bllok ushqimi 110 – 240V AC;</li> </ul>
<b>Karakteristikat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mundësojë për shtresën 2 (Layer 2) PVLAN, CDP, IEEE 802.1Q VLAN standard, 802.1ad, 802.1w, MSTP;</li> <li>• Të mundësojë aftësi rutimi: (RIPv1, RIPv2, EIGRP, OSPF, IS-IS, PBR, PIM Stub Multicast (1,000 routes), HSRP, VRRP, PBR, BSR, MSDP, IP SLA, QoS, FHS, SXP, IP SLA Responder, SSO);</li> <li>• Siguria: 802.1X, MACsec-128 , CoPP, suport i listës së kontrollit të aksesit mbështetës (ACL);</li> <li>• QoS, Mundësia e klasifikimit të trafikut bazuar në prioritetet e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP dhe Klasa e Shërbimit (CoS), Shaped Round Robin (SRR), CIR, 8 linja dalje për portë, etj.;</li> <li>• Të mundësojë segmentim të rrjetit si: VRF, VXLAN, LISP, SGT;</li> <li>• Të mundësojë vizibilitet dhe telemetri të tipit NetFlow, SPAN, RSPAN;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) që suportojnë filtrim të trafikut duke u bazuar në informacionet nga shtresa L2 deri në L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, në VLAN dhe në portë;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve të industrisë në bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Menaxhim me SSH, HTTPS, SNMP dhe me server qendror të tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar në adresat MAC me Radius Server;</li> <li>• Kontroll aksesi bazuar në identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN në nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojje nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim në distancë në CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan në disa versione file të konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për të përzgjedhur në bazë ACL trafikun hyrës/dalës nga një portë ose VLAN dhe të pasqyrojë atë në një portë lokale ose remote;</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	Pajisja Switch do të jetë e licencuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Temperatura e operimit: 0 – 40 grade Celsius;</li> <li>• Lagështira relative e operimit: 5% to 90%, pa kondensim ;</li> </ul>

<b>Garancia</b>	1 (një) vit suport nga prodhuesi me dërgim të pajisjes në ditën vijuese të punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit të përfshira.
-----------------	--

## Sistem Backup

### Server – Sasia 1 copë

<b>Karakteristika minimale teknike</b>	
Formati	Server i montueshëm në kabinet (rack) 1U. Aksesorët e montimit të përfshirë.
